

Nr. Prot. 024/B/20

VENDIM Nr. 1595

Për

Miratimin e

“Rregullores për Pagesat për Mbikëqyrjen e Tregut të Komunikimeve Elektronike dhe Shërbimeve Postare”

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 4, nenit 27, paragrafi 1), 2), 3) dhe 4), nenit 79 paragrafi 1) dhe 2), neni 81 paragrafi 1) dhe nenit 83 paragrafi 1), të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (*tutje referuar si - LKE*); nenit 28 të Ligjit Nr. 06/L-038 për Shërbime Postare (*tutje referuar si - LSHP*) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- | | |
|-----------------------|-------------|
| 1) z. Nijazi Ademaj, | Anëtar |
| 2) z. Hazir Hajdari, | Anëtar |
| 3) z. Bahri Anadolli, | Anëtar, dhe |
| 4) z. Shqiprim Pula, | Anëtar, |

në mbledhjen e 54-të me radhë të mbajtur më datë 24 Qershor 2020, pas shqyrtimit të draft Rregullores për Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, komenteve të operatorëve, si dhe rekomandimit të Departamenteve përkatëse, vendosi si më poshtë:

V E N D I M

- I. Miratohet ‘Rregullores për Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare’.
- II. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: “Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”

Neni 27 paragrafi 1 përcakton që: “Ndërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve dhe qarkullimi i të cilave është mbi njëqind mijë (100,000) Euro, janë të detyruar të paguajnë një pagesë vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike nga Autoriteti. Kjo pagesë bëhet për t’i mbuluar kostot administrative të Autoritetit.

Neni 28 paragrafi 1 i Ligjit për Shërbime Postare përcakton që: Ofruesit e shërbimit postar janë të detyruar të paguajnë pranë Autoritetit, pagesën vjetore për mbikëqyrjen e tregut të shërbimeve postare.

Në përputhje me nenin 82 të Ligjit, draft rregullorja para aprovimit ka kaluar në procedurën e konsultimit publik, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është që me anë të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut, sipas nivelit të llogaritur mbi bazën e kësaj rregulloreje, të garantohet financimi i nevojshëm për mbulimin e kostove administrative të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si -Autoriteti*) për ushtrimin e veprimtarisë si organ kompetent në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

Andaj, Bordi i Autoritetit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 07/07/2020

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Aktvendimi i dërgohet:

- Ofruesve të shërbimeve të Komunikimeve Elektronike
- Departamentit Ligjor,
- Arkivës së Autoritetit.